

Oda e Stomatologeve te Kosovës (OSK)

Auditimi funksional i Organeve të OSK-së

/ Pasqyrat Financiare 2023/



Prill 2024

Raport i auditimi funksional i Organeve të OSK-së

Hyrje

Bazuar ne Specifikimet teknike të paraqituara ne dosjen e tenderit se OSK-së përveq dhenies së Opinionit për Pasqyrat fianciare 2023 të Odës së Stomatologeve të Kosovës (OSK) konform Standardeve Nderkombetare të Auditimit (SNA) , kemi marrë përgjegjësinë të kryejmë auditimin funksional të Organeve të OSK-së e cila njeherit është pjesë përberëse e Raportit të Auditorit .

Ne këtë Raport do të prezentojm performancën dhe gjetjet eventuale të cilat nuk vlersohen si materiale por me shumë janë si mosrespektim i parimeve dhe rregolloreve ne disa raste

Ne vijim ju prezentojmë gjetjet lidhur pasqyart financiare 2023 si dhe vlersimet tona lidhur me punen e organeve të OSK-së për këtë periudhë.

1). Performanca e organeve të OSK-së per vitin 2023

Sipas kërkeses së Odës dhe duke u bazuar ne Ligjin Nr.04/L-150 për Odat Profesionale Shëndetësore , Statutin e OSK-së ne kemi marrë persipër që të auditojmë performancën e organeve të OSK-së për periudhën 2023.

Konform nenit 18 të Statuti të OSK -së , Oda ka të themeluar keto organe :

- ❖ Kuvendin ,
- ❖ Kryetari Odes ,
- ❖ Keshilli Drejtues ,
- ❖ Keshilli mbikqyres,
- ❖ Keshilli Etik, Gjyqi i nderit, Prokurori i Odës dhe
- ❖ Komisionet e përhershme

Mbeshtetur ne nenin 47 të Statutit Oda ka për obligim tansparencën dhe raportimin për punën e Organeve dhe Komisioneve të perhershme të OSK-së.

Bazuar ne Raportin vjetor 2023 të Odës verjtëm se janë kryer shumë aktivitete konformë përgjegjësiave dhe kompetencave të cilat kishim i veqar si me poshtë :

- Miratimi i akteve normative nga Kuvendi
- Miratimi i disa Rregulloreve nga Keshilli Drejtues (KD)
- Monitorimi i punës se Organeve të OSK-së KD
- Formimi dhe emrimi i komisioneve për nevojate OSK-së
- Miratimi i Projekt buxhetit te OSK-së per vitin 2023
- Miratimi i Planit të punës të Odes per 2023
- Aprovimi i Marrveshjes për nderitimin e pperbashket të OPSH-ve
- Zgjedhja e e Prokurorit , zv prokurorit dhe anëtarve të KD
- Zgjedhja e Kryetarit të OSK-së dhe emrimi I zv.Kryetarëve
- Emërimi i anëtarve të KQZ-së
- Mbeshtetja financiare për disa punime shkencore
- Mbeshtetja financiare e disa anëtarve të OSK-së nga komisioni për solidaritet
- Marrveshje bashkpunimi me institucionet e ndryshme vendore .
- Bashkëpunimi nderkombetarë lidhur me aktivitetet stomatologjike.

2. Zbatueshmëria e akteve normative për vitin 2023 nga ana e organeve të OSK-së

a) Vlerësimi i punës së Organeve të OSK-së

Kuvendi si organi më i lartë i OSK-së ka kryer punën duke u bazuar në përgjegjësitë e tij që dalin nga neni 20 i Statutit të OSK-së poashtu Kryetari i OSK-së si organ ekzekutiv ka kryer funksionin bazuar në kompetencat që dalin nga neni 23 i Statutit të OSK-së dhe neni 9 i Rregullores për procedurën vendimtare të OSK-së.

Këshilli Drejtues (KD), bazuar në procesverbalet e KD konstatojmë se KD gjatë kësaj periudhe ka mbajtur disa takime ku janë marrë vendime të rëndësishme dhe nga mostrat e perzgjedhuara për verifikim të aktiviteteve për KD si organ kyq i Odës nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi për punën e tij gjatë kësaj periudhe. Bazuar në Raportin vjetor lidhur me aktivitetet e realizuara të Këshillit mbikqyrës gjatë kësaj periudhe ashtu siç kërkohen me neni 29 pikë 1.1 mbikqyrja e afarizmit financiar të Odës, nuk vërehet rast për ndonjë shkelje të drejtave të antarëve të Odës,

Këshilli Etik dhe Gjyqi i Nderit dhe Prokurori i Odës si organe të mbrojtës së profesionit dhe vetë komunitetit, bazuar në raportet e Komisionit për çështje etike dhe deshmitë tjera të verifikuara e vlerësojmë se në përgjithësi janë zbatuar kompetencat që dalin nga nenet 31, 34 dhe 35 të Statutit të OSK-së, ku gjatë periudhës nga Komisioni për çështje etike janë shqyrtuar 6 kërkesa të ndryshme.

b). Vlerësimi i punës së Komisioneve të OSK-së

Komisionet e përhershme , bazuar në nenin 37 të OSK-së od aka të themeluar 6 Komisione të përhershme dhe fushveprimtaria e tyre është e percaktuar me Rregullore të mbrendshme të miratuara nga Kuvendi Odës.

- ❖ Nga raportet e **Komisionit për Licencim** shihet se gjatë kesja periudhe janë antërasuar rreth 165 stomatolog , janë Licencuar mbi 172 po aq edhe janë rilicencuar 304 anëtarë si dhe janë leshuar rreth 60 gjoba për vonesa. Nga mostrat e perzedhura për verifikim të ratseve për licencim dhe ri-licencim të anëtarve konstuam se komisioni ka respektuar aktet normative të përcaktuara ne rregulloren për Licencim të profesionisteve shendetësor.
- ❖ **Komisioni per Edukim të Vazhdueshem profesional (EVP)** për këtë periudhe bazuar ne raportet e tij ka mbajtur disa kofnerenca, seminare , ligjerata , kurse etj të cilat aktivitete janë organizuar konformë Rregulloreve te OSK-së.
- ❖ **Komisioni për buxhet dhe financa** per vitin 2023 ka shqyrtuar dhe aprovuar raportet financiare dhe projektine e buxhetit të OSK-së për vitin 2023. Departamenti i financave dhe kontabilitetit të OSK-së ka mirëmbajtur dhe avansuar evidencat kontabël duke kompletuar listen e anëtarve të OSK-së si bazë për të hyart e Odës duke finalizuar me Pasqyrat vjetore financiare Janar-Dhjetor 2023. Bazuar Krahasuar pozicionet e Pasqyrave financiare e vitit 2023 ne raport me ato të vitit paraprak 2022 ka rezultuar me nje rritje të hyrave rreth 24% e mjeteve financiare mbi 42 mijë euro me shumë duke krijuar një gjendje stabile financiare.

Bazuar ne mostrat e perzgjedhura për verifikim konstatojmë se shpenzimet e buxhetit janë ekzekutuar ne harmoni me Rregulloren e OSK-së per menaxhimin e financave duke zbatuar procedurat e prokurimit publik për shumat mbi limitin e caktuar sipas nenit 4 pika 2 e Rregullorës Nr.1060.

3.) Rasti i mospermbushjës së Kontratës lidhur me zhvillimin e sistemit operativ të OSK-së

Bazuar në kontratën e lidhur me 06.12.2022 me operatorin ekonomik Abacussoft ,për zhvillimin e Sistemit Operativ të OSK-së , i cili parashihej të perfundonte punën 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës . Ky projekt nuk është finalizuar edhe pse është kryer pagesa në shumë prej 1890 eur nga ana e OSK-së.

Për këtë rast nësi auditor kemi kërkuar një arsyetim nga drejtuesit e Odës të cilët kanë dhënë verzionin e tyre si më poshtë :

Bazuar në kërkesën e zv. Sekretarit të përgjithshëm me nr.prot.2288 të datës 29.03.2022 për zhvillimin e sistemit informativ të OSK-së me qëllim të dhënies së shërbimeve sa më cilësore dhe një hap nxitës drejt realizimit të mirëqeverisjes dhe transparencës së plotë ndaj anëtarëve të OSK-së, duke përmirësuar qasjen bashkëkohore në shërbimet e OSK-së, kjo kërkesë është aprovuar nga Këshilli Drejtues me vendim nr. prot. 2296 të dt. 01.04.2022.

Sipas kërkesës për ofertë realizimi i platformës parashihej të bëhej në dy faza të zhvillimit të saj. Faza e parë përgatitja e infrastrukturës së platformës dhe faza e dytë testimi dhe lansimi i saj.

Pas përfundimit të procedurave të prokurimit, për realizimin e projektit është përzgjedhur kompania Abacus Soft me të cilin është lidhur kontrata për kryerjen e punëve dhe detyrave specifike ku përfshihet përgatitja e infrastrukturës si vijon: sigurimi dhe mirëmbajtja e adresës së platformës në internet, hostimi i platformës, moduli i menaxhimit të platformës, dizajni, pronësia e platformës dhe siguria.

Faza e dytë e projektit me kërkesën tonë nuk ka filluar fare të zhvillohet, për shkak se organizata LuxDevelopment ka njoftuar OPSH-të, e me këtë edhe OSK-së, se kanë përzgjedhur operatorin ekonomik 'Kutia' për zhvillimin në tërësi të platformës digjitale për të gjitha Odat e Profesionistëve Shëndetësor, dhe kjo platformë është donacion i plotë i LuxDevelopment.

Me këtë ju njoftojmë se kompania Abacus Soft ka përmbushur të gjitha detyrat e parapara sipas kontratës për zhvillimin e fazës e parë të zhvillimit të platformës digjitale.

Komentet e Menaxhmentit lidhur me Raport i auditimi funksional i Organeve të OSK-së

1. Pas shiqimit dhe leximit të draft raportit të auditimit funksional të OSK-së për vitin 2023, ne konstatojmë që sa i përket pikës 1 dhe 2, komentet e dhëna nga auditori i jashtëm janë të qëndrueshme dhe të pranueshme, ndërsa;
2. Sa i përket pikës 3. Rasti i mospërbushjes së kontratës lidhur me zhvillimin e sistemit operativ të OSK-së, ne kemi dhënë opinionin tone dhe arsyeshmërinë e bazuar në fakte, të cilin ju kemi dërguar nëpërmjet email-it.

Komenti i Auditorit :

Bazuar ne arsyetimet e argumentuara të Menaxhmentit lidhur me konstatimet tona rreth performancës se Organeve të Osk-së per vitin 2023, ne pajtohemi me keto përgjigje.

Letrën e punoi :

Haxhi Nimanaj, auditor ligjor


